



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FIER

DREJTORIA E MENAXHIMIT TË PRONAVE

Nr. 7341 Prot.

Fier më 18.06.2025

Projekt - Vendim
Nr. 68 dt. 18.06.2024

“Për miratimin në parim të kërkesës së Shoqatës Sportive të Futbollit «Eagles Football Club» për dhënie në përdorim në funksion të aktiviteteve sportive, të pasurisë “fushë sporti”, ZK 3015 me sipërfaqje 10 100 m², ndodhur në fshatin Pojan Njësia Administrative Dërmënas Fier, pronë e Bashkisë Fier”.

Këshillit të Bashkisë Fier, sot më datë _____.06.2025, i paraqitet për shqyrtim materiali i përgatitur nga Drejtoria e Menaxhimit të Pronave, bazuar në kërkesën zyrtare nr. 3627 prot. datë 25.03.2025 të paraqitur nga Shoqata Sportive e Futbollit «Eagles Football Club», si dhe informacionin e marrë me shkresën nr. 458/1 prot. datë 08.04.2025 protokolluar me nr. 4397 dt. 10.04.2025 nga Njësia Administrative Dërmënas, Bashkia Fier, bazuar në nenin 54, shkronja "e/1" dhe neni 25 pika 4 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, Ligjin Nr. 8744, date 22.02.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në Njësitë e Qeverisjes Vendore", Ligjin nr. 115/2014, datë 31.07.2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë. (i ndryshuar), VKM 510 dt. 10.06.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në Njësitë e Qeverisjes Vendore, të prekura nga riorganizimi administrative – territorial", VKM 95 dt. 31.01.2007 "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Komunën Dërmënas Qarku Fier", VKM nr. 854 dt. 04.12.2012 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Njesisë Administrative Dërmënas Bashkia Fier Qarku Fier", Kryetari i Bashkisë:

Propozon:

1. Miratimin në parim të kërkesës së Shoqatës Sportive të Futbollit «Eagles Football Club» për dhënie në përdorim në funksion të aktiviteteve sportive të pasurisë “fushë sporti”, ZK 3015 me sipërfaqje 10 100 m², ndodhur në fshatin Pojan Njësia Administrative Dërmënas Fier, pronë e Bashkisë Fier.
2. Ngarkohet ekzekutivi i Bashkisë Fier për vijimin e mëtejshëm të procedurave administrativo – ligjore të përcaktuara nga ligji.

Drejtoria e Menaxhimit të Pronave

Drejtori: A. Behari

Drejtoria Juridike

Drejtoreshë: E. Kapllanaj

KRYETARI

Armando SUBASHI

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Martin DODI